



Rrahja është keqtrajtim
dhe jo ndëshkim

Udhëzues
për prindërit, arsimtarët dhe edukatorët
kundër ndëshkimit fizik të fëmijëve



Skopje, 2016

“Udhëzues për prindërit, arsimtarët dhe edukatorët”

Kundër ndëshkimit trupor të fëmijëve

Shkup, 2016

ISBN 978-608-4603-09-2

Titulli: Udhëzues për prindërit, arsimtarët dhe edukatorët – kundër ndëshkimit trupor të fëmijëve

Botues: Ambasada e parë për fëmijë në botë Megjashi– Republika e Maqedonisë

Drejtori ekzekutiv dhe themelues: mr. Dragi Zmijanac

Redaktore: Jana Zengovska

Lektura: Armend Nuhiu

Recenzues: doc. d-r Sasho Koçankovski

Përpunimi grafik dhe shtypja: „Bato dhe divajn“

Përkthimi në gjuhën shqipe: Armend Nuhiu

Adresa e botuesit:

Ambasada e parë për fëmijë në botë Megjashi– Republika e Maqedonisë

Rr. Ksta Novakoviç, nr. 22a, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë

Tel/faks: +389 2 2465 316

E-mail: info@childrensembassy.org.mk

www.childrensembassy.org.mk

Përmbajtja:

Parathënie.....	5
Hyrje	7
<u>Çka paraqet keqpërdorimi fizik i fëmijës</u>	8
1. <u>Indikatorë të njohjes së fëmijëve që janë keqtrajtuar fizikisht</u>	10
1.1 <u>Sikisht jellja e fëmijës së keqtrajtuar fizikisht:</u>	11
1.2 <u>Cilët janë ata prindër /të rritur të cilët i lëndojnë fëmijët e tyre?</u>	12
Sjellja e të rriturit	13
2. <u>Çfarë pasojash lë ndëshkimi fizik te fëmijët</u>	13
3. <u>Veprimi gjatë keqtrajtimit të fëmijëve</u>	15
<u>Njohja dhe zbulimi i keqtrajtimit dhe anashkalimit</u>	16
3.1.1 <u>Njohja dhe zbulimi i keqtrajtimit dhe anashkalimit</u>	16
<u>Njohja nëpërmjet kumtimit direkt nga ana e fëmijës</u>	16
<u>Njohja e shenjave fizike ose psikike që tregojnë për keqtrajtim të mundshëm të fëmijës</u>	18
<u>Dyshim për keqtrajtim dhe anashkalim</u>	18
<u>Konsultime dhe vlerësimi i keqtrajtrimit dhe rrezikut nga keqpërdorimi .</u>	19
<u>Dokumentimi i gjendjes së fëmijës dhe rrethanat e keqtrajtimit dhe anashkalimit</u>	20
<u>Denoncimi (raportimi) i keqtrajtimit dhe anashkalimit</u>	20
<u>Denoncimi i keqtrajtimit ekzistues ose dyshimit për të njëjtin në QPS</u>	20
<u>Denoncimi i dyshimit për keqtrajtim dhe anashkalim deri në polici ose prokurori publike.....</u>	21
<u>Planifikimi i shërbimeve/ intervenimeve dhe masat e mbrojtjes.....</u>	23

<u>Intervenimi urgjent</u>	24
<u>Ofrimi i sigurisë së fëmijës</u>	24
Literatura.....	26

Parathënie

Publikim jashtëzakonisht i rëndësishëm, e cila në një gjuhë të lehtë dhe të kuptueshme flet për ndëshkimin trupor, keqtrajtimin e fëmijëve, për rëndësinë e prindërisë së përgjegjshme në edukimin dhe në përgjithësi në zhvillimin e përgjithshëm të fëmijës.

Ky publikim ka për qëllim që ta përmbushë hapësirën në edukimin dhe përgatitjen e vetëdijes për këto dukuri të padëshirueshme, të cilët janë në rritje te fëmijët në Republikën e Maqedonisë. Është e dedikuar në rradhë të parë për fëmijët, prindërit, arsimtarët, mësimdhënësit dhe edukatorët e institucioneve publike dhe private të cilët punojnë me fëmijët, por edhe për të gjithë ata që janë të përfshirë në arsimimin joformal.

Këtë udhërrëfyes mund t`a shfrytëzojnë edhe anëtarët e shërbimeve profesionale të këtyre institucioneve arsimoro-edukative, qendrat për punë sociale, policia, shëndetësia...

Nga ky udhërrëfyes dobi edhe më të madhe do të kenë fëmijët, prindërit, mësimdhënësit, psikologët, pedagogët, punëtorët socialë dhe mjekët, të cilët pas dyshimit ose identifikimit të keqpërdorimit ndaj fëmijës, tregojnë për obligimin e tyre që të ndërmarrin masa adekuate për denoncimin e tyre në institucionet kompetente /SOS qendrat, me qëllim të mbojtjes nga keqtrajtuesit.

Poashtu mund të shfrytëzohet edhe për qëllime arsimore në institucionet edukative-arsimore në mësimin joformal.

Informatat e shumta të cilat janë ofruar për ndikimin negativ të dhunës në zhvillimin e përgjithshëm të fëmijëve, si dhe mënyrat dhe format e edukimit, do t`u ndihmojë prindërve që ta ndryshojnë dhe përmirësojnë sjelljen e tyre, jo vetëm ndaj fëmijëve të tyre por edhe ndaj fëmijëve në përgjithësi.

Sepse qëllimi i prindërisë nuk është vetëm mbrojtja e fëmijëve, por edhe krijimi i ambientit për zhvillimin e tyre të plotë, ku do të mund që ti

realizojnë potencialet e tyre në gëzim, dashuri, mirëkuptim, respektim dhe mbështetje.

Me kënaqësi e rekomandoj këtë udhërrëfyes.

13.06.2016
Manastir

Doc. D-r Sasho Koçankovski
Doktor i shkencave psikologjike dhe
terapeut i Geshtalt-it

Hyrje

Ndëshkimi trupor është njëra nga format më të shpeshta të keqpërorimit të fëmijëve. Duke filluar nga ndëshkimi në shtëpi, e deri te ndëshkimet në shkolla dhe në çerdhe si masë edukativo-përmirësuese për “fëmijët e padëgjueshëm”.

Sipas Komitetit të KB-ve për të drejtat e fëmijëve:- Çdo dënim ku përdoret forcë fizike e me qëllim që të shkaktohet nivel i caktuar i dhimbjes ose shqetësimit, pa marrë parasysh se sa e vogël është dhimbja, paraqet ndëshkim trupor të fëmijës”.

Sipas UNICEF-it, problemi ka përmasa të mëdha. Hulumtimet tjera tregojnë se rreth 70% e fëmijëve të moshës prej 2 deri në 14 vjet i nënshtrohen ndonjë lloji të keqtrajtimit fizik ose psikologjik në shtëpi ose nga ana e përkujdesësit; 16% i nënshtrohen ndëshkimit serioz trupor.

Ndëshkimi trupor mund të shkaktojë probleme serioze, para së gjithash shëndetësore, te fëmijët, e në disa raste kjo përfundon edhe me vdekje. Në Republikën e Maqedonisë në dy vitet e fundit jemi dëshmitarë të rasteve në të cilat prindërit i kanë rrahur fëmijët e tyre deri në vdekje. Të gjitha këto informata, të cilat i marrim para së gjithash nga mediet e që kanë të bëjnë me pasojat e ndëshkimit trupor, duhet të na nxisin të mendojmë seriozisht për mënyrën në të cilën mund të mbrohen fëmijët, para së gjithash nga dhuna në shtëpi.

Ky udhëzues u dedikohet prindërve, arsimtarëve dhe të rriturve të tjerë dhe qëllimi i tij është të informojë para së gjithash se çka paraqet ndëshkimi trupor, çfarë pasojash le për shëndetin dhe jetën e fëmijëve.

Njëkohësisht, qëllimi i tij është të nxiten qytetarët, arsimtarët dhe shërbimet profesionale në çerdhe dhe në shkolla që t'i denoncojnë rastet për të cilat ka dyshime për keqpërdorim të fëmijëve.

¹ Rekomandimet e Komitetit të OKB-së nga ana e Komitetit për të Drejtat e Fëmijës, qershor 2010

[http://www.unicef.org/tfymacedonia/macedonian/CRC.C.M1KD.ConcludingObservationsMK\(1\).pdf](http://www.unicef.org/tfymacedonia/macedonian/CRC.C.M1KD.ConcludingObservationsMK(1).pdf)

Çka paraqet keqpërdorimi fizik i fëmijëve?

E drejta e fëmijëve që të mbrohen nga keqtrajtimi fizik është shënuar në nenin 19 të Konventës për mbrojtje të fëmijëve. ”Shtetet- anëtare do të ndërmarrin të gjitha masat adekuate juridike, administrative, sociale dhe arsimore për shkak të mbrojtjes së fëmijëve nga të gjitha llojet e dhunës fizike dhe mentale, lëndimeve ose keqpërdorimeve, anashkalimit dhe sjelljes anashkaluese, maltretimit dhe eksploatimit, përfshirë këtu edhe eksploatimin seksual, përderisa për atë kujdesen prindërit, kujdestarët ligjorë ose persona tjerë të cilëve u është besuar kujdesi për fëmijën”

Sipas komitetit të Komitetit të KB-ve për të drejtat e fëmijëve:- “Çdo dënim ku përdoret forcë fizike e me qëllim që të shkaktohet nivel i caktuar i dhimbjes ose shqetësimit, pa marrë parasysh se sa e vogël është dhimbja, paraqet ndëshkim trupor të fëmijës”.

Në Protokollin e përbashkët për veprim në rastet e keqpërdorimit dhe anashkalimit të fëmijëve, në faqen 36, thuhet se – “Keqpërdorimi fizik definohet si përdorim i qëllimshëm i forcës fizike kundër fëmijëve, që shkakton lëndim, ose ka mundësi ta dëmtojë shëndetin e fëmijëve, mbijetesën, zhvillimin ose dinjitetin e tyre. Kjo përfshin: goditjen, rrahjen, shkelmimin,

trëndjen, kafshimin, kapjen për fytin, përvëlumin, djegien, helmimin dhe zënien e frymës”.

Dënimi që përdoret më shpesh me qëllim që të dicitinohen fëmijët paraqet ndëshkimi trupor i fëmijëve. Qëllimi është që me ndihmën e dënimit që do të shkaktojë dhimbje të fëmija të vijë deri te ndryshimi i sjelljes së caktuar që nuk është e pranueshme për fëmijët/kujdestarët dhe të gjithë ata të cilëve u është besuar përkujdesja për ruajtjen edhe edukimin e fëmijës.

1. Indikatorët për njohjen e fëmijëve që janë të keqpërdorur fizikisht

2 Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës e Kombeve të Bashkuara është Marrëveshje për të drejtat e njeriut në të cilën përcaktohen të drejtat civile, politike, ekonomike, sociale, shëndetësore dhe të drejtat kulturore të fëmijëve. Konventa në përgjithësi përcakton një fëmijë si çdo qenie njerëzore nën moshën tetëmbëdhjetë vjet, përveç nëse sipas ligjit të një shteti të caktuar mosha madhore është arritur më herët.

3 Marrë dhe përshtatur nga Protokoli i përbashkët për veprim në rastet e abuzimit dhe neglizhimit të fëmijëve, Trupi Nacional Koordinues për Mbrojtjen e Fëmijëve nga abuzimi dhe anashkalimi i fëmijëve, 2014

- Blanat dhe shtypjet e paqarta ose të paspjegueshme të pjesëve të mbuluara të trupit (stomak, shpinë, pjesën e pasme e kërcit dhe të kofshës),
- Vragët

- Skuqjet ose mavijosjet në formë të ndonjë sendi (litar, rrip, shkop, pëllëmbë)
- Flokët e shkulura, dhëmbët që mungojnë
- Kafshimet
- Djegiet, shkaktimi i të cilave nuk mund të sqarohet (prej cigareve, lëngjeve të vluara, në formë të dorezës, në formë të çorapit, nga rryma)
- Thyerjet, përdredhjet ose lëndimet e kokës që nuk mund të sqarohen
- Helmimi me helme, mjete korozive, substanca psikoaktive

1.1 Sjellja e fëmijës që është i keqpërdorur fizikisht:

- Frika nga kontakti fizik me të rriturit
- Frika nga prindi ose ndonjë anëtar tjetër i familjes
- Frikësohet nga qarja e fëmijëve të tjerë
- Lehtë shastiset nga irritimet
- Tregon ekstreme në sjellje – agresion ose tërheqje
- Anksiozitet i tepruar
- Me lehtësi u afrohet të rriturve dhe të panjohurve
- Nuk lejon të kontrollohet
- Nuk e duron kontaktin fizik ose preken
- I ka shtëpia
- Nuk mund të vendosë raporte të mira me moshatarët
- Ka vetëbesim të ulët

1.2 Kush janë ata prindër/të rritur që i lëndojnë fëmijët e tyre?

Sipas statusit fizik, arsimor ose social-ekonomik të prindit nuk mund të parashihet se cili prind fizikisht e keqpërdor fëmijën e tij.

Mirëpo, ka disa mostra të sjelljes të këta prindër ose të rritur, me ndihmën e të cilëve do të mund ta parashohim keqpërdorimin e mundshëm të fëmijës.

Sjellja e të rriturit:

- Hidhërimi, mosdurimi, shpesh e humbin kontrollin mbi sjelljen e tyre
- Duken të pasigurt sa i përket gjendjes së fëmijës
- E konsiderojnë fëmijën të keq dhe shkak për të gjitha problemet e tij në jetë
- Shprehin rezistencë për të biseduar për gjendjen e fëmijës ose të familjes
- Çdo çështje e sheh me dyshim
- Përdor mënyra për dicitplinimin që nuk përkojnë me moshën e fëmijës
- Jep sqarime jologjike, kontradiktore ose jobindëse për lëndimet e fëmijës ose fare nuk jep asnjë sqarim
 - Tregon mirëkuptim të pamjaftueshëm ose nuk tregon aspak mirëkuptim për zhvillimin normal të fëmijës

- Ka pritje nga fëmija që nuk janë në përputhje me moshën e tij.

Edhe përkundër faktit se çdo formë e ndëshkimit fizik është e papranueshme, shumë shpesh ka shembuj ku prindërit në moment nuk dijnë se si të përballen me sjelljen e fëmijës, dhe e përdorin dënimin sikurse goditje të duarve, bythëve, shkulje të flokëve ose veshëve me qëllim të vendosjes së kufinjve dhe tregimit të fuqisë. Më shpesh, këto forma të ndëshkimit trupor përdoren me qëllim që fëmija të mësojë një sjellje të caktuar të pranuar sociale.

Mirëpo, pa marrë parasysh se cila formë e ndëshkimit trupor të përdoret, ajo nuk ka efekt dhe mund të shkaktojë përforcim të sjelljes së padëshiruar, paraqitje të mllëfit dhe hidhërimit, të cilën fëmija nuk shpreh në momentin e dhënë për shkak të fikës, mirëpo ajo akumulohet dhe mund të shkaktojë reagime të furishme në kontekst tjetër.

2. Çfarë pasojash le ndëshkimi trupor të fëmijët

Për këta fëmijë karakteristike është ajo se kur qarkullojnë në mënyrë dominante e tregojnë fuqinë e tyre fizike. Kanë pamje agresive në fytyrë, kohë pas kohe me grushta i godasin muret ose ndonjë kundërshtar të trilluar. Prindërit e këtyre fëmijëve konsiderojnë se ndëshkimi trupor është mënyrë e mirë dhe e vetme e edukimit. Njëkohësisht edhe këta prindër janë edukuar në atë mënyrë, gjatë fëmijërisë së tyre vazhdimisht kanë tentuar që të mos

gabojnë diçka që të mos i rrahin. Në këto familje nëna konsideron se fëmija nuk guxon të rrehet, mirëpo kur aty nuk është babai, i cili është dhunuesi “kryesor”, nëna përdor mënyra të tjera të ndëshkimit dhe vazhdimisht i kërcënohet duke përdorur fjalë fyese dhe kërcënime. Këtij fëmije, i cili është i rrahur shpeshherë, prindërit nuk i vendosin kërkesa të qarta dhe nuk i tregojnë se çka kërkohet saktë prej tij, e poashtu nuk i thuhet se çka ka bërë gabim. Nëse e pyesim këtë fëmijë se cila ka qenë arsyeja për të cilën e kanë rrahur herën e fundit, nuk do ta dijë të na thotë. Nëse i pyesim prindërit se pse nuk e lavdërojnë fëmijën e tyre, kur do të bëjë diçka që është e shkëlqyeshme, ata do të përgjigjen se do ta lavdërojnë vetëm atëherë kur do ta ndryshojë sjelljen e tij. Në shikim të parë duket sikur ky fëmijë ka mendim të mirë veten e tij, mirëpo ana e tij e jashtme nuk përputhet me ndjenjat e vërteta të këtij fëmije. Për shkak të porosive që i pranon nga prindërit e tij, ky fëmijë ndjehet i pafuqishëm, se nuk e meriton dashurinë dhe kujdesin e të tjerëve, askujt nuk i beson dhe vazhdimisht jeton në frikë se dikush do ta godasë. Ky fëmijë çdo prekje e kupton si ndëshkim trupor. Pamja dominante është vetëm maskë me qëllim që dikush të mos i afrohet dhe ta sulmojë. Ky fëmijë ka problem në procesin e pavarësisht dhe funksionimit në mjedisin social. Fëmijët që ndëshkohen fizikisht identifikohen me agresorin, me atë që i keqtrajton dhe në atë mënyrë përpiqen dhe bëhen të njëjtë sikurse agresori. Këta fëmijë marrin vendim se asnjëherë më nuk do të jetojnë në dhunë, dhe një ditë kur do të rriten do t’i kundërvihen babait të tyre ose dikujt tjetër që e ndëshkon fizikisht. Mirëpo, nga ana tjetër këta fëmijë janë të pafuqishëm dhe të predispozuar që gjithmonë të jenë viktimat. Për këtë arsye ata mund të jenë të tërhequr, kronikisht të frikësuar me

qëllim që të mos jenë shkak që dikush t'i sulmojë ose t'i lëndojë. Këta fëmijë e përjashtojnë nga sjellja e tyre çdo mundësi që ata të jenë shkaktarë të dhunës.

3. Veprimi gjatë keqpërdorimit të fëmijëve¹

Sipas Protokollit të përbashkët për veprim në raste të keqpërdorimit dhe anashkalimit të fëmijëve të vitit 2014, veprimi nënkupton:

1. Dallimi/Njohja nga ana e profesionistëve, nëpërmjet konstatimit të drejtpërdrejtë ose dallimit/njohjes së indikatorëve të keqpërdorimit dhe anashkalimit të fëmijëve ose dyshimit;
2. Denoncimi i keqpërdorimit dhe anashkalimit, si dhe i dyshimit për keqpërdorim dhe anashkalim në qendrën për punë sociale, polici ose në prokurorinë publike;
3. Vlerësimi i gjendjes, nevojave dhe rrezikut nga keqpërdorimi dhe anashkalimi i fëmijës dhe familjes pas denoncimit të rastit në Qendrën për punë sociale (QPS)

Koordinimi e gjithë procesit e zhvillon dhe përkujdeset për të organi kompetent ose **qendra për punë sociale**.

¹Marrë dhe përshtatur nga Protokollit i përbashkët për veprim në raste të keqpërdorimit dhe anashkalimit të fëmijëve të vitit 2011, Qeveria e Republikës së Maqedonisë

Njohja dhe zbulimi i keqpërdorimit dhe i anashkalimit

Zbulimi i keqpërdorimit ose anashkalimit të fëmijëve është njëri nga proceset më të ndjeshme dhe njëkohësisht edhe hapi parë në drejtim të mbrojtjes së fëmijëve. Nga mënyra e njohjes varet veprimi i mëtutjeshëm dhe rrjedha e tij. Zbulimin zakonisht e bëjnë profesionistët që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me fëmijët dhe profesionalisht kujdesen për ta, si p.sh. (edukatorët, punëtorët shëndetësorë, motrat medicinale mjekët, arsimtarët, psikologët, pedagogët, punëtorët socialë etj.)

3.1.1 Njohja dhe zbulimi i keqpërdorimit dhe anashkalimit

Njohja nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë nga ana e fëmijës.

Fëmija që është viktimë e keqpërdorimit ose anashkalimit i besohet personit për të cilin konsideron se është i besueshëm. Këta njerëz të besueshëm mund të jenë (prindër, përkujdesës, arsimtarë,të afërm, shërbimet profesionale në institucionet publike, moshatarë, etj.) Ky njeri ose këta njerëz të besueshëm me të cilët fëmija ka marrë guximin dhe ka vendosur që të flasë për gjendjen në të cilën gjendet është moment kyç në veprimin e mëtutjeshëm. Ky njeri duhet t'i japë mbështetje të vazhdueshme fëmijës, ta inkurajojë dhe t'i ofrojë ndjenjë

të sigurisë, dhe njëkohësisht duhet të angazhohet gjatë procesit me qëllim të mbrojtjes së tij.

Në Protokollin e përbashkët për veprim në raste të keqpërdoriimit dhe të anashkalimit të fëmijëve, nga i cili i prezantojmë këto informata në faqen 12, thuhet:

Nëse fëmija ju drejtohet si person i besueshëm në lidhje me keqpërdorimin ose anashkalimin e përjetuar, atëherë...:

- Gjeni një vend të qetë që të mund ta dëgjoni;
- Dëgjojeni në mënyrë të qetë jovlerësuese;
- Dëgjojeni fëmijën, në vend që ta pyesni drejtpërdrejt;
- Fëmija nuk duhet të detyrohet të japë informata, të merret në pyetje ose t'i jepen premtim të rrejshme për besueshmëri të plotë;
- Bindeni fëmijën se ajo që i ka ndodhur, nuk ka ndodhur me fajin e tij;
- Asnjëherë mos e ndërpritni fëmijën përderisa është duke i kujtuar ngjarjet e rëndësishme;
- Respektoni ndjenjat e fëmijës
- Thoni se do të përpiqeni t'i ndihmoni;
- Shkruajeni atë që e keni parë dhe që e keni dëgjuar;
 - a) shënioni fjalët e fëmijës sa më saktë që është e mundur
 - b) përdorni fjalë që i përshkruajnë gjërat që ua thotë fëmija

Vërejtjet dhe informatat ruani në mënyrë të besueshme dhe të sigurt. Profesionisti duhet t'ia sqarojë fëmijës obligimin për t'i informuar shërbimet e tjera. Me marrjen sistematike dhe rutinore në pyetje nga ana e profesionistëve, psikologëve, punëtorëve socialë, punëtorëve

shëndetësorë për ekzistimin eventual të dhunës te fëmija mund të fitohen informata që e vërtetojnë këtë. Mirëpo, çdo marrje tjetër në pyetje duhet të zhvillohet sipas parimit të mbrojtjes së fëmijës nga ritraumatizimi. Marrja e panevojshme plotësuese në pyetje e fëmijës për të cilin ekziston dyshimi se është keqpërdorur, paraqet viktimizim.

Dallimi i shenjave fizike dhe psikike që tregojnë se një fëmijë mund të jetë keqpërdorur

Profesionistët në bazë të shenjave fizike dhe psikologjike që i ka ose që i shfaq fëmija, duhet atë ta marrin në pyetje në mënyrë më sistematike për atë se si është lënduar. Gjatë konstatimit se a bëhet fjalë për anashkalim apo keqpërdorim duhet të merren parasysh të gjitha rrethanat, duke e përfshirë edhe gjendjen e përgjithshme të fëmijës dhe të familjes së tij. Gjatë vlerësimit duhet pasur shumë kujdes, nëse merret parasysh fakti se nuk ka shenja të veçanta, në bazë të të cilave, fillimisht do të mund të themi me siguri se ai ka qenë i keqpërdorur ose i anashkaluar.

Dyshimi për keqpërdorim dhe anashkalim

Në rast të dyshimit për keqpërdorim dhe anashkalim të fëmijës, pa pasur me këtë rast informatë të qartë se ka dhunë, profesionistët që vijnë në kontakt me fëmijën ose familjen e tij, rastin duhet ta paraqesin në qendrën për punë sociale, në polici ose prokurorinë publike.

Pasi rasti të denoncohet në ndonjërin nga institucionet e përmendura kompetente, ato veprojnë në këtë mënyrë:

Konsultime dhe vlerësimi i keqpërdorimit dhe i rrezikut nga keqpërdorimi

Kjo do të thotë se para se të paraqitet dyshimi për keqpërdorimin eventual të fëmijës, profesionist duhet të bëjë disa konsultime:

- **Konsultimet brenda në vetë shërbimin** me kolegët që janë të informuar për problemin. Konsultimi nuk guxon ta shtyjë procesin e përkujdesjes urgjente të fëmijës në qoftë se ka nevojë për këtë.
- **Konsultimet me prindin/kujdestarin** e fëmijës në qoftë se ky konsultim nuk e rrezikon drejtpërdrejt sigurinë e fëmijës.
- **Konsultimet me shërbimet tjera**, të cilat ndoshta kanë informata për fëmijën dhe për familjen e tij (QPS, shërbimet – SOS, institucionet shëndetësore, institucionet edukativo-arsimore etj.). Qëllimi është të fitohen informata plotësuese që do të ndihmonin në procesin e mbrojtjes së fëmijës.
- **Konsultimet me shërbimet shëndetësore**, në rast se të fëmija ka shenja fizike ose të keqpërdorimit seksual. Konsultimet kryesisht janë me pediatrin, mjekun amë, në qoftë se ka nuk ka pediatër dhe gjinekolog.

Dokumentimi i gjendjes së fëmijës dhe rrethanat e keqpërdorimit dhe të anashkalimit

Cili do qoftë resor që do ta zbulojë se një fëmijë është keqpërdorur ose anashkaluar, duhet t'i dokumentojë të dhënat që kanë të bëjnë me fëmijën, llojin e keqpërdorimit dhe autorin e keqpërdorimit. Është me rëndësi të shënohet:

- Identiteti i fëmijës (emri dhe mbiemri, numri amë, gjinia dhe mosha),
- shoqërimi nga ana e personave të tjerë
- autorin e përmendur të keqpërdorimit
- gjendjen e fëmijës
- përshkrimi i sjelljes së fëmijës, deklaratat në lidhje me ngjarjen, si dhe deklaratat e shoqëruesve
- nëse ka mundësi mund të bëhen fotografi (të lëndimeve, vendit të ngjarjes) që do të shfrytëzohen gjatë procedurës së mëtutjeshme

3.1 Denoncimi i keqpërdorimit dhe anashkalimit

3.1.1 Denoncimi i keqpërdorimit aktual ose i dyshimit për ekzistimin e tij në QPS

Denoncimi i rastit në qendrën për punë sociale pason pas realizimit të intervistës me fëmijën. Pastaj profesionisti që e ka realizuar intervistën e informon prindin jo të dhunshëm se rastin do ta paraqesë në QPS,

mirëpo vetëm në rastet kur konsideron se kjo nuk do ta zvogëlojë rrezikun nga keqpërdorimi i mëtutjeshëm i fëmijës.

Profesionisti që do ta paraqesë rastin duhet ta plotësojë formularin ku do t'i shënojë të gjitha të dhëna për fëmijën dhe familjen të cilat i ka të njohura dhe do t'i arsyetojë konstatimet dhe shkakun për të cilin e denoncon rastin.

Mund të presë me denconimin e rastit, nëse institucioni te i cili paraqitet dyshim për keqpërdorim ose anashkalim ka ekip të trajnuar për mbrojtjen e fëmijëve nga keqpërdorimi dhe anashkalimi. Në qoftë se ky ekip i ka shqyrtuar rrethanat dhe gjendjen e fëmijës dhe ka konstatuar se:

- Rreziku nga keqpërdorimi dhe anashkalimi i fëmijës është i ulët;
- Familja e fëmijës ka kapacitet dhe dëshiron të bashkëpunojë dhe të ndryshojë me qëllim të mbrojtjes së fëmijës;
- Institucioni ka kapacitet të merret me problemet e fëmijës dhe familjen e tij
- Vendimin për shtyrjen e denoncimit të rastit duhet ta sjellë ekipi i institucionit

3.1.2 Denoncimi i dyshimit për keqpërdorim dhe anashkalim te policia ose prokuroria publike

Denoncimi te këto institucione bëhet në rastet kur bëhet fjalë për veprime që e rrezikojnë shëndetin dhe jetën e fëmijës dhe atëherë kur bëhet fjalë për vepra penale që ndiqen sipas detyrës zyrtare. Vepra të

tilla janë: lëndimet e rënda trupore, kërcënimet ndaj jetës së fëmijës dhe keqpërdorimi seksual.

Këto vepra denoncohen nga ana e profesionistëve, ose nga qytetarët dhe institucionet që kanë njohuri për to. Ato denoncohen në MPB, prokurorinë publike.

Gjatë denoncimit duhet:

- Të bëhet kontroll i detajuar shëndetësor i fëmijës
- Fëmija të qetësohet në aspekt psikologjik
- Të trajtohen lëndimet
- Të dokumentohen lëndimet dhe sjellja e fëmijës

Të gjithë profesionistët që denoncojnë keqpërdorim dhe anashkalim duhet të:

- T'u ndihmojnë në mënyrë aktive shërbimeve kompetente (QPS-së, MPB-së, prokurorisë publike) për mbrojtjen e fëmijës
- T'i përgjigjen thirrjes për shqyrtimin e gjendjes së fëmijës dhe familjes së tij
- Të marrin pjesë në marrjen e vendimeve për masat për mbrojtjen e fëmijës dhe të familjes së tij
- Ta mbajnë kontaktin me fëmijën dhe familjen e tij, duke luajtur rol të rëndësishëm në këndelljen e fëmijës dhe parandalimin e dhunës

Policia dhe prokuroria publike janë të obliguara që ta mbrojnë identitetin e profesionistit që e denoncon rastin dhe të sigurojnë informata për të drejtat dhe obligimet e tyre në procedurat e mëtutjeshme.

3.2 Planifikimi i shërbimeve/intervenimeve dhe masat e mbrojtjes

Pas denoncimit që është dërguar në qendrën për punë sociale, në qoftë se rezultatet e vlerësimit inicial tregojnë se ka nevojë për mbrojtjen e fëmijës për shkak të anashkalimit ose keqpërdorimit, duhet të caktohet një takim ndërmjet resorëve ku do të planifikohen intervenimet me qëllim të mbrojtjes së fëmijës.

Takimin ndërmjet resorëve e thërret bashkëpunëtorin përgjegjës profesional nga qendra për punë sociale, që është emëruar për rastin konkret.

Në këtë takim duhet të thirren dhe të jenë të pranishëm:

- Bashkëpunëtorët e emëruar profesionalë nga sektorët dhe institucionet e tjera që janë të trajnuar për punë me fëmijë të anashkaluar dhe të keqpërdorur (shëndetësore, arsimore, policia, sociale, etj).
- Personat e tjerë që e njohin fëmijën dhe familjen e tij
- Fëmija dhe prindi/kujdestari jokeqpërdorës
- Profesionistët e tjerë që planifikohet të kyçen në punën me fëmijën

Takimi ndërmjet resorëve, ndërlidhet me vlerësimin inicial dhe të detajuar të përgatitur nga ana e profesionistëve në QPS, dhe në qoftë se pajtohe me të, kalon në planifikimin e aktiviteteve me qëllim të mbrojtjes së fëmijës.

Në këtë takim duhet:

- Të zhvillohet plani individual për punë me shfrytëzuesin
- Të përcaktohet, kush, për çka dhe kur do të veprojë
- Të caktohet takimi i ardhshëm për revizion
- Të përgatitet plan rezerv në qoftë se masat e parapara për mbrojtje nuk mund të realizohen

Intervenimi urgjent

Intervenimi urgjent ndërmerret kur janë të rrezikuar shëndeti dhe jeta e fëmijës, ose nëse ka dyshim se mosndërmarrja e masave urgjente do tarrezikonte shëndetin dhe jetën e fëmijës. Ky intervenim mund të jetë i domosdoshëm në momentin e denoncimit ose gjatë procedurës së mëtutjeshme. Qëllimi është të ofrohet siguria e nxënësit.

Ofrimi i sigurisë së fëmijës

Situata e shënuara më poshtë mund të jenë shkak për ndërmarrjen e intervenimit urgjent.

- Prezenca e lëndimeve të rënda te fëmija ose mundësia për paraqitjen e lëndimeve të rënda të shkaktuara nga veprime të caktuara (hudhja e fëmijës, kërcënimi me armë, maltretimi i fëmijës, ndëshkimi i rëndë i fëmijës)
- Gjendja shëndetësore e fëmijës kërkon shërim urgjent, të cilin prindi/kujdestari nuk është në gjendje ta sigurojë ose nuk dëshiron ta ofrojë
- Fëmija më i vogël se 5 vjet është lënë pa mbikëqyrje përkatëse prindore ose në rrethana të rrezikshme

- Fëmija është lënë pa mbikëqyrje të prindit/kujdestarit, i cili për shkak të gjendjes fizike ose sëmundjes mentale nuk është në gjendje të kujdeset për fëmijën (gjendje psikotike, tepër agresiv, nën ndikimin e drogës ose të alkoolit, i sëmurë kronik etj.)
- Nëse fëmija ka mundësi t'i nënshtrohet hakmarrjes ose shantazhit nga ana e prindit/kujdestarit, si rezultat i situatave paraprake në të cilat ai ka qenë i nënshtuar në mënyrë eksplicite

Intervenimi urgjent nënkupton veprim të shpejtë të disa sektorëve dhe shkëmbim të informatave (policia, shëndetësia, shërbimet sociale), duke i përfshirë edhe takimet konsultuese me qëllim të miratimit të zgjidhjes dhe të planit që ka për qëllim mbrojtjen e fëmijës.

Nëse konstatohet se rreziku ndaj jetës së fëmijës buron nga familja, fillohet procedura për marrjen e të drejtës prindore dhe emërimin e një kujdestari deri sa të merret vendimi gjyqësor. Në qoftë se fëmija është i rrezikuar në familjen përkujdesëse, fillohen veprime të tjera adekuate kundër autorëve, me ç'rast nëse bëhet fjalë për fëmijë të moshës që mund ta shprehë mendimin e tij në lidhje me përkujdesjen duhet të merret parasysh mendimi i tij.

Literatura:

1. Protokoli i përbashkët për veprim në rastet e keqtrajtimit dhe anashkalimit të fëmijëve, 2014, Qeveria e Republikës së Maqedonisë
2. Libër i vogël për prindërit e mëdhenj 2009(Z. Milivojeviq , K. Bilban, B.Kokelj. M. Kramberger, T.Steiner, B. Kozhuh)
3. Psikologjia zhvillimore , 2004, (O. Мурцева Шкарик)